



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	17.10.2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/683/MMPHI/
<b>PËR/ZA/TO:</b>	" Haliti- Beton" Sh.p.k. Suharekë Bazë për Prodhimin e Betonit, Mushtisht, Suharekë.
<b>CC:</b>	Komisioni për Leje Mjedisore
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit " Haliti-Beton" Sh.p.k. Suharekë, me nr.prot.24/683/MMPHI, Bazë për Prodhimin e Betonit, Mushtisht, Suharekë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/683/MMPHI  
Datë: 26.09.2024


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Operatorit, "Haliti- Beton" Sh.p.k. Suharekë, i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje, për veprimtarinë: Bazë për Prodhimin e Betonit, Mushtisht, Suharekë, në ngastrën, P- 72116029-00995-0 dhe P- 72116029-00994-0, zona kadastrale Mushtisht, Suharekë.

## A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për vazhdimin e Lejes Mjedisore për operatorin, "Haliti-Beton" Sh.p.k. Suharekë, për veprimtarinë: Bazë për Prodhimin e Betonit, Mushtisht, Suharekë, në ngastrën, P- 72116029-00995-0 dhe P- 72116029-00994-0, zona kadastrale Mushtisht, Suharekë, MMPHI, konstaton që operatori nuk ka plotësuar kushtet administrative për vazhdim të Lejes Mjedisore.



Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 dhe ka gjetur që mungon Leja për Aktivitet të Veçanta nga KPMM, por është dokumentuar me Njoftim nga KPMM, me nr. 1389, të datës 31.01.2024.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: dt. 26.09.2024, konstatoi se operatori "Haliti- Beton" Sh.p.k. Suharekë, për veprimtarinë: Bazë për Prodhimin e Betonit, Mushtisht, Suharekë, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërpre në procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.